

VENDIM
Nr.49, datë 16.9.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, pika 9.2, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2005, pasi shqyrtoi aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2006,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2006.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema